	<p>2. Shndërrimet e lëndës</p>	<p>lëndëve të pastra dhe lëndëve të përziera.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metodën e ndarjes së lëndëve të përziera në lëndë të pastra. <p>2. Shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë të tretshme dhe të pätretshme në ujë - Lëndët e rëndësishme për jetë. - Burimet e energjisë <p>3. Shndërrimet e lëndës mund të shkaktjnë ndotjen e mjedisit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja e ujit, e ajrit dhe e Tokës nga ndotja. 	<p>pambukun, plastikën, letrën etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojnë lëndët e pastra nga lëndët e përziera p.sh.; uji i shiut, uji i detit, uji i turbull, sheqeri kristalor, çaji, kafja, kripa kristalorë e gjellës, uji me kripë etj.; - Të përshkruajnë Tokën si burim i lëndëve të përziera; - Të demonstrojnë metodën e ndarjes së lëndëve të ngurta të përziera, p.sh., me sitje, me magnet etj.; të lëndëve të ngurta të përziera me lëngje, p.sh., me dekantim, filtrim, avullim etj. - Të tregojnë se lëndët mund ta ndryshojnë formën dhe përmbajtjen në vartësi nga faktorët e jashtëm që ndikojnë (temperatura, shtypja etj.), - Të përshkruajnë se ngrohja ose ftohja e lëndëve shkakton ndryshime, p.sh., tek uji, brumi, çokollata etj. - Të demonstrojnë shndërrimet e kthyeshme p.sh., ngrirja, shkrirja dhe avullimi i ujit. - Të demonstrojnë shndërrimet e pakthyeshme p.sh., djegia e qiriut, drurit, sheqerit, letrës etj. - Të vlerësojnë ujin, ajrin si lëndë të 	<p>praktike me materiale të ndryshme (letër, dru, plastikë, pëlhura të ndryshme, etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Edukatë qytetare <p>Vetëdijësimi për ruajtjen e shëndetit dhe mjedisit jetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Art figurativ <p>Përdorimin e lëndëve të ndryshme gjatë vizatimeve, ngjyrosjeve dhe modelimeve të ndryshme (lapsi grafit, ngjyrat, plastelina, etj.).</p> <p>Matematikë</p> <p>Njohja e numrave natyrorë gjatë matjes dhe</p>
--	---------------------------------------	--	---	---

			<p>rëndësishme për jetë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të analizojnë pse Toka është burim i të mirave materiale të njeriut: lëndëve të para të ndryshme, burime të ushqimit etj. - Të indentifikojnë disa nga lëndët konkrete të rëndësishme për jetë; materialet ndërtimore, druri, pemët, perimet, lëndët e djegshme etj. - Të vlerësojnë dhe të vetëdijësohen për sjelljet e domosdoshme, korrekte të përgjegjshme duke evituar rreziqet e mundshme që mund të ndodhin nga faktori njeri. - Të vlerësojnë se ruajtja e mjedisit është në dobi të shëndetit tonë dhe të komunitetit të gjerë shoqëror. 	<p>njehsimeve të madhësive të ndryshme (temperaturës, gjatësisë, masës, vëllimit) dhe hartimit të grafikëve dhe tabelave.</p>
Proceset fizike	1. Forca dhe lëvizja	<ul style="list-style-type: none"> • Me ndihmën e metrit i përcaktojmë largësitë në mes të trupave në natyrë, gjatësitë e tyre dhe mund t'i krahasojmë ato. • Litri është njësia matëse e lëngjeve. • Përcaktimi i vëllimit të trupave të parregullt. Shtytja. • Njësia matëse e kohës është 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë shembuj për matje të gjatësisë, metrin si njësi, nënfishat e tij dhe raportet në mes tyre. • Të përdorë metrin për matje të largësive në mes të trupave, për matje të gjatësive të tyre dhe t'i krahasojë ato. • Të përkufizojë litrin me ndihmën e 	<p>Me punë dore për ndërtimin e veglërive që paraqiten në program. Me matematikë për shprehje të madhësive që ceken këtu.</p>

		<p>sekonda.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia matëse e masës është kilogrami (kg). • Të gjithë trupat bymehen dhe tkurren duke ua rritur dhe zvogëluar temperaturën. • Temperatura e trupave matet me termometra të llojeve të ndryshme. • Të gjithë trupat në natyrë bëjnë shtypje në vendin ku qëndrojnë. • Në materiale të ndryshme zëri përhapet me shpejtësi të ndryshme. • Trupat në natyrë në mes veti zënë pozita të ndryshme. • Trupat në mes veti lëvizin duke u fërkuar. • Përveç makinave të thjeshta njeriu në jetën e përditshme i shfrytëzon edhe makinat e përbëra. 	<p>vëllimit të kubit me brinjë 1 dm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë nënfishat e litrit dhe raportet në mes të tyre. • Të ilustrojë me fjalë dhe të demonstrojë mënyrën e përcaktimit të vëllimit të trupave të parregullt dhe shtytjen në trup të zhytur. • Të përcaktojë kohën në çfarëdo çasti nga vrojtimi i pozitës së treguesve të orës. • Të tregojë numrin e orëve që ka ditata, numrin e minutave që ka ora dhe numrin e sekondave që ka minuta dhe ora. • Të përkufizojë kilogramin si njësi për matje të masës, nëntishat e tij dhe raportet në mes tyre. • Të shpjegojë me demonstrim bymimin e trupave gjatë zmadhimit të temperaturës së tyre. • Të gjejë shembuj të bymimit dhe të tkurrjes së trupave në natyrë duke ua zmadhuar dhe zvogëluar temperaturën (anomalia e ujit). • Të shpjegojë parimin e punës së termometrit mjekësor, duke u 	
--	--	---	---	--

			<p>mbështetur në dukurinë e bymimit të lëngjeve dhe përkufizimin e gradës së Celsiusit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjejë shembuj të shtypjes së trupave në natyrë dhe të njohë veçoritë e saj. • Të paraqesë prova për shpejtësi të ndryshme të zërit në ajër, ujë dhe metale dhe të shpjegojë jehonën. • Të tregojë kuptimin e pozitave në mes të trupave si: larg dhe afër, djathtas dhe majtas, para dhe prapa, nën dhe mbi, lart dhe poshtë etj. • Të gjejë shembuj nga jeta e përditshme për fërkimin në mes të trupave dhe mënyrën e zvogëlimit apo zmadhimit të tij. • Të dallojë punën me makina të thjeshta • (dora e njeriut, pyka) nga puna me makina të përbëra (gërshërët, thyesi i arrave, darët, karroca me një rrotë, vinçi dhe biçikleta). 	
	<p>2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekszitojnë shumë prova për paraqitjen e elektriciteti statik. • Trupat në natyrë bashkëveprojnë duke u takuar apo pa u takuar fare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të paraqesë prova nga jeta e përditshme për ekzistimin e elektricitetit statik. • Të gjejë shembuj bashkëveprimi të trupave në natyrë, duke u takuar dhe 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë trupat ndriçues janë burime të dritës. 	<p>duke mos u takuar fare në mes veti, (mekanikë, magnetizëm dhe astronomi).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë lloje të ndryshme burimesh të dritës dhe veçorinë e përbashkët të tyre. 	
Toka dhe hapësira	1. Rrethina ime	<ul style="list-style-type: none"> • Njeriu dhe rrethina <ul style="list-style-type: none"> - Format e sipërfaqes tokësore, shkëmbinjtë mineralet, tokat - Ajri (atmosfera), përbërja, vetitë (nxehja dhe ftohja, lagështia, shtypja e ajrit lëvizja, reshjet, erërat, erërat në rrethinën time dhe vetitë e tyre) , moti - Uji , vetitë, trupat ujorë, qarkullimi i ujit, proceset kryesore, trupat ujorë në rrethinën dhe në vendin tim. 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë vetitë fizike të mjedisit natyror në rrethinën e tij (pozitën, formën, dimensionet, ndërtimin). - Të tregojë rolin e mjedisit natyror lokal për botën e gjallë dhe aktivitete njerëzore (laryshia natyrore e rrethinës). - Të hulumtojë tiparet e relievit të rrethinës (fushë, kodër, mal, shpat, luginë, lumë, liqen etj.) - Të përshkruajë shkëmbinjtë, mineralet dhe vetitë e tyre. - Të përshkruajë tipat kryesorë të tokave dhe shfrytëzimin e tyre në rrethinën e tij. - Të tregojë përbërjen e atmosferës. - Të vrojtojë ndryshimet e motit duke përdorur fjalët ditë me shi, ditë me vranësira, ditë me mjegull etj. 	<ul style="list-style-type: none"> * Art figurativ, <ul style="list-style-type: none"> - Prezantim grafik i tipareve të natyrës. * Punë dore, <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i modeleve të ndryshme. * Edukatë qytetare, <ul style="list-style-type: none"> - Njerëzit jetojnë dhe veprojnë në hapësirë lokale, raportet e tyre. Njerëzit jetojnë në

	<p>2. Skica, plani, harta, globi, leximi dhe përdorimi</p>	<p>• Skica, plani, harta, globi, leximi dhe përdorimi i planeve dhe hartave, orientimi në natyrë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të diskutojë kushtet e ndryshme të motit nëpër stinët e vitit dhe ndikimet e tyre në jetën dhe aktivitetet e njeriut, të bimëve, të kafshëve në rrethinë. - Të përdorë instrumentet për matjen e elementeve të motit (termometri, barometri, shimatësi, erëmatësi). - Të shpjegojë qarkullimin e ujit në natyrë. - Të identifikojë trupat kryesorë ujorë në rrethinë e më gjerë (lumi, liqeni, deti, oqeani). - Të tregojë se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe tërë Toka mund të paraqiten në letër, glob të zvogëluara dhe me shenja të veçanta. - Të dallojë skicën, planin dhe hartën. - Të skicojë planin e klasës, të shtëpisë dhe të shkollës. - Të dallojë planin, hartën e trevës (vendbanimit) dhe fotografinë ajrore. - Të dallojë simbolet kryesore dhe përmbajtjet themelore të hartës. - Të caktojë drejtimet themelore në hartë. - Të shpjegojë globin dhe tipat e tyre. 	<p>treva të ndryshme, raportet e tyre</p> <p>* Gjuhë</p> <p>- Përdorimi standard i koncepteve.</p>
--	---	---	---	--

			- Të tregojë pozitën e Kosovës në hartë dhe fqinjët e saj.	
	3. Toka, Sistemi Diellor dhe Gjithësia	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi Diellor, Dielli-burim i energjisë, i dritës dhe i jetës në Tokë. • Trupat e Sistemit Diellor, pse njeriu hulumton dhe pushton Gjithësinë. • Toka dhe lëvizjet e saj, • ndërrimi i stinëve të vitit dhe rrjedhojat, Hëna-përcjellesë e Tokës • Korja e Tokës dhe vetitë e saj (kontinentet dhe oqeanet), shkëmbinjtë, pasuritë energjetikë dhe minerale të korës tokësore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë trupat qiellorë në Sistemin Diellor. - Të përshkruajë vetitë fizike të përbashkëta të trupave qiellorë dhe ndryshimet në mes tyre. - Të përshkruajë se Dielli është trup qendror i Sistemit Diellor dhe burim i dritës, i nxehtësisë dhe i jetës në Tokë. - Të tregojë pse njeriu i hulumton trupat e Sistemit Diellor dhe Gjithësinë. - Të përshkruajë lëvizjet e Tokës rreth boshtit të vet dhe Diellit. - Të përshkruajë ndryshimet e pozitës së Diellit gjatë ditës dhe vitit. - Të shpjegojë ndikimet e ndërrimeve të ditë-natës, stinëve të vitit dhe të motit. - Të tregojë se shtresa e jashtme e Tokës quhet korja e tokës. - Të dallojë sipërfaqet tokësore-kontinentet dhe sipërfaqet ujore - oqeanet. 	

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të lëndës Njeriu dhe Natyra është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, peizazhe, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë kuzhine, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike, bashkëkohore – kompjuter, internet etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të: njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera participojnë në tërësinë e formimit të personalitetit për t'u përballur me sfida jetësore.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitave në objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të matur punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një instrumenti

matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi, stafi arsimor, shkolla dhe komuniteti i saj. Vlerësimi si sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve, përfshin këto forma vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe punimeve me shkrim etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdorë mjete e teknika të shumëllojta vlerësimi dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësues;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojë për përmirësimin e mësimit mbështetur në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimit dhe mësuesit e planit dhe e programit Njeriu dhe Natyra , mësimit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Literaturë për lëndën Njeriu dhe Natyra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja botërore..
- 2) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 3) Fotografí, atlasë, modele, skema, diagrame, makete, harta, glob etj.
- 4) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 5) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 6) Literaturë tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjete të tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësues, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësues duhet t'i takojë edhe nxënësit.

EDUKATË QYTETARE

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Përmbajtja programore e mësimëve që mësohen në klasën e katërt është vazhdimësi po edhe zgjerim i njohurive në disa kategori dhe nënkategori që janë zhvilluar në klasën e parë dhe të dytë si mësim zgjedhor si dhe në klasën e tretë si lëndë e obligueshme.

Kështu nga kategoria **Zhvillimi Individual dhe Identiteti** (që është zhvilluar edhe në klasën e parë, të dytë dhe të tretë) do të zhvillohet nënkategoria “shëndeti”; nga kategoria **Qeverisja dhe Qytetaria** nënkategoria “Ligji”.

Rëndësi e veçantë edhe në programin e klasës së katërt do t’i kushtohet kategorisë **Të Drejtat dhe Përgjegjësitë**, ku më gjerësisht do të mësohet për liritë dhe të drejtat e njeriut, përkatësisht fëmijëve, si dhe për detyrat dhe përgjegjësitë që burojnë prej tyre. Ndërsa, nga kategoria **Ekonomia dhe teknologjia** nxënësit do të njihen me konceptet themelore si puna, prodhimi dhe konsumi. Vend i veçantë do t’u kushtohet: **kujdesit për mjedisin** si dhe **ndryshimeve në natyrë dhe në shoqëri** nga kategoritë përkatëse.

Siç shihet, ky program përfshin sfera të ndryshme interesimi të nxënësve, prandaj si i tillë do të jetë atraktiv dhe interesant për nxënësit.

Natyrisht përmbajtjet mësimore që do të zhvillohen në këtë program, do të jenë në harmoni me zhvillimin psiko-fizik të nxënësve të kësaj moshe.

QËLLIMET

Lënda e edukatës qytetare ka për qëllim:

- Vetëdijesimin e nxënësve për rëndësinë e shëndetit, për jetën dhe për mirëqenien e individit;

- Ndërgjegjësimin e nxënësve për njohjen dhe respektimin e ligjit , si rregullator i të gjitha sferave të jetës së një shoqërie;
- Aftësimin e nxënësve në njohjen dhe në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, përkatësisht fëmijëve, si dhe në inkurajimin e tyre për luftimin e të gjitha formave të diskriminimit njerëzor;
- Që nxënësit të kuptojnë se realizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut nënkupton edhe detyra dhe përgjegjësi konkrete të tyre;
- Përvetësimin dhe zbatimin e nocioneve (koncepteve) themelore ekonomike si puna, prodhimi dhe konsumi;
- Krijimin e shprehive për zhvillimin dhe për ruajtjen e mjedisit jetësor;
- Njohjen e ndryshimeve në natyrë dhe në shoqëri;
- Të kontribuojë në zhvillimin e vetëdijes së nxënësit se dukuritë janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyrë të kushtëzuar dhe se janë në ndërveprim reciprok.

OBJEKTIVAT

Nxënësi:

Të njohë:

- ✓ strukturën organizative dhe funksionin e institucioneve kryesore shëndetësore si: ndihma e shpejtë (emergjenca), shtëpia e shëndetit, ambulanca, farmacia, dentisti, spitali etj.;
- ✓ rregullat, normat, adetet dhe ligjet themelore që e rregullojnë jetën në familje, në shkollë dhe në komunitet;
- ✓ liritë, të drejtat, si dhe detyrat e përgjegjësitë e tyre, në familje, në shkollë dhe më gjerë;
- ✓ konceptet themelore ekonomike si: puna, prodhimi, ffermat, ndërmarrjet, konsumi, paraja, bankat etj.;
- ✓ dhe pranojë si të natyrshme ndryshimet e përhershme që ndodhin në natyrë dhe në shoqëri.

Të kuptojë:

- ✓ ç'është shëndeti, rëndësinë e shëndetit dhe të higjienës, rëndësinë e ushqimit për mirëqenien e njeriut;
- ✓ arsyen e zhvillimit të ligjeve, rolin e policisë dhe gjykatave dhe rolin e tyre në rregullimin e jetës demokratike në shoqëri;
- ✓ drejt përmbajtjen dhe natyrën e të drejtave, lirive, detyrave dhe përgjegjësive të njeriut (përkatësisht fëmijës), të dijë se si realizohen dhe si mbrohen ato;
- ✓ se puna, prodhimi, konsumi, paraja, bankat etj., janë faktorë qenësorë për zhvillimin e shoqërisë, si dhe mirëqenies së çdo individi;
- ✓ rëndësinë e mjedisit për shëndetin e njeriut;
- ✓ se ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri janë dukuri dhe fenomene normale dhe të natyrshme.

Të analizojë:

- ✓ faktorët dhe veprimet që ndihmojnë në zhvillimin dhe në ruajtjen e shëndetit;
- ✓ pasojat e veprimeve të ligjshme, përkatësisht veprimeve të paligjshme në situata konkrete;
- ✓ realizimin e të drejtave të njeriut në familje, në shkollë dhe në komunitet, si dhe qëndrimin e tyre ndaj detyrave dhe përgjegjësive që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të tyre;
- ✓ procesin e krijimit të të mirave materiale, efektet e kursimit, si dhe pasojat nga konsumi i tepruar etj.;
- ✓ raportin ndërmjet dëshirave dhe mundësive reale ekonomike për veprime në situata konkrete me të cilat ndeshet në jetën e përditshme;
- ✓ se si mbrohet mjedisi, cili është efekti i tij për shëndetin e njeriut, si dhe të analizojë veprimet e tij në raport me mjedisin jetësor;
- ✓ efektet e ndryshimeve të përhershme që ndodhin në natyrë dhe në shoqëri.

Të vlerësojë:

- ✓ rëndësinë e ushqimit, mjekut dhe barnave për ruajtjen e shëndetit, ndikimet e dëmshme të mjedisit të ndotur, të drogës, të duhanit dhe të alkoolit për shëndetin e njeriut, etj.;
- ✓ respektimin e normave (adeteve), rregullave dhe ligjeve për funksionimin e institucioneve demokratike si familje, shkollë, komunitet e më gjerë;
- ✓ rolin e policisë dhe të gjykatës për mbrojtjen e lirisë së njeriut;
- ✓ nivelin e realizimit të të drejtave të fëmijëve në rrethin ku jeton, qëndrimin ndaj detyrave të marra, si dhe raportin ndërmjet lirisë të fëmijëve dhe ndjenjës së përgjegjësisë ndaj obligimeve të tyre;
- ✓ rolin dhe rëndësinë e faktorëve themelorë ekonomikë, si puna, prodhimi, energjia, gazi, nafta, qymyri, konsumi, paraja, tregu etj., në krijimin e të mirave materiale, përkatësisht jetës më të mirë të njerëzve;
- ✓ nevojën për zhvillimin dhe për ruajtjen e mjedisit të shëndoshë jetësor si dhe vlerëson gjendjen e faktorëve themelorë jetësorë si uji, ajri dhe toka;
- ✓ ndryshimet e përhershme që ndodhin në natyrë dhe në shoqëri.

Të zhvillojë qëndrime dhe vlera:

- ✓ të mbajë qëndrim pozitiv ndaj institucioneve shëndetësore, personelit shëndetësor si dhe të respektojë rregullat higjienike si: higjienën e trupit dhe të gojës, të ushqimit, regjimin ditor si dhe ushtrimet e rregullta fizike etj.;
- ✓ të mbajë qëndrim kritik ndaj një norme, rregulli apo ligji si dhe të argumentojë qëndrimin e tij ndaj normës, rregullit apo ligjit të caktuar;
- ✓ të demonstrojë dëshirë dhe vullnet për njohjen dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut (fëmijëve), si dhe të ndjejë përgjegjësi për përmbushjen e detyrave të tyre;
- ✓ të jetë i hapur dhe kritik ndaj të gjitha formave dhe kategorive ekonomike që sigurojnë gjërat themelore jetësore si: ushqimin, veshmbathjen, strehimin dhe zhvillimin në përgjithësi.

STRUKTURA E PROGRAMIT

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve
ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI	Shëndeti	16
QEVERISJA DHE QYTETARIA	Ligji	10
TE DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË	Liritë dhe të drejtat e njeriut -fëmijës. Detyrat dhe përgjegjësitë	18
EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA	Puna, prodhimi dhe konsumi	12
KULTURA	Kujdesi për mjedisin	8
KOHA DHE NDRYSHIMET	Ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri	10
Gjithsej		74

❖ ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Shëndeti

Nxënësit duhet të përvetësojnë përmbajtjet e koncepteve themelore për shëndetin: Shëndeti dhe higjiena; trupi i fëmijës; fuqia e muskujve; dhëmbët dhe dentisti; vizitë të mjeku; sëmundjet; barnat dhe farmacia; ndihma e shpejtë; spitali dhe ambulanca; mjedisi dhe shëndeti; ushqimi; sporti etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së shëndetit, duke respektuar këshillat e dhëna (nga prindi, mësuesi, mjeku);
- ✓ të dallojë dentistin nga mjeku, ambulancën nga spitali;
- ✓ të emërtojë disa nga shërbimet shëndetësore, si dhe funksionet e tyre, ku mund të realizojë mbrojtje shëndetësore;

- ✓ të përshkruajë ndihmën dhe kujdesin që duhet treguar për të afërmit dhe miqtë në rast nevoje;
- ✓ të vlerësojë rëndësinë e gjumit të rregullt, ushqimit, sportit, përshatjes së veshmbathjes me qëllim të ruajtjes së shëndetit.

❖ QEVERISJA DHE QYTETARIA

Ligji

Për ligjin si nënkategori të Qeverisjes dhe Qytetarisë nxënësit duhet të mësojnë: Rregullat dhe ligjin; rregullat në shkollë dhe në komunitet; rolin e policisë; gjykatat; krimet; dënimet, dhuna në familje; dhuna në shkollë; si të mbrojmë veten etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të shpjegojë domosdoshmërinë e rregullave dhe ligjit në funksionimin e shoqërisë demokratike;
- ✓ të përshkruajë disa nga detyrat e policisë dhe gjykatës;
- ✓ të zbatojë rregullat e mirësjelljes në rrugë dhe në shoqëri;
- ✓ të përshkruajë shembuj të rasteve ku shkelen rregullat në grup, në bashkësi të klasës dhe komunitet;
- ✓ të përshkruajë disa nga format e shprehjes së dhunës në familje dhe në shkollë.

❖ TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

Liritë dhe të drejtat e njeriut /fëmijëve; Detyrat dhe përgjegjësitë

Nga nënkategoria Liritë dhe të drejtat e njeriut-fëmijës nxënësit duhet të përvetësojnë konceptet që kanë të bëjnë me: botën e lirisë dhe të drejtave; të drejtat e fëmijës; të drejtat dhe liria e njeriut; e drejta për një emër, familje dhe atdhe; e drejta për jetë; e drejta e arsimimit; e drejta e lojës, puna e fëmijëve, miqësia etj.

Nga Detyrat dhe përgjegjësitë nxënësit duhet të mësojnë për: detyrat dhe përgjegjësitë, detyrat në shkollë; përgjegjësitë ndaj familjes; ndihmën

atyre që kanë vështirësi dhe njerëzve me nevoja të veçanta; respektin ndaj të moshuarve; korrektësinë etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të dallojë kategoritë kryesore të të drejtave, si: të drejtën e shprehjes së lirë, të drejtën për shkollim, të drejtën për jetë, për pronë, për lojë, etj.;
- ✓ të identifikojë të drejtat që lidhen me: lirinë e njeriut, opinionin dhe shprehjen e tij, punën dhe sigurimin e të mirave materiale, profesionin, arsimimin, jetën e përbashkët në komunitet;
- ✓ të shpjegojë rëndësinë që kanë detyrat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët;
- ✓ të identifikojë detyrat dhe përgjegjësitë për vetveten, për të tjerët, mjedisin ku jeton;
- ✓ t'i analizojë qëndrimet e caktuara për çështjet që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e veta dhe të të tjerëve.

❖ EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA

Puna, prodhimi dhe konsumi

Për këtë nënkategori nxënësit duhet të përvetësojnë konceptet që kanë të bëjnë me: punën dhe shoqërinë; botën e punës; sigurimin e të mirave materiale; fermat dhe ndërmarrjet prodhuese; energjinë dhe elektricitetin; gazin, naftën dhe qymyrin; erën, burimet ujore dhe energjinë diellore; paratë; bankat, përdorimi dhe kursimi i parave në familje; prodhuesit dhe konsumatorët; tregtinë.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të kuptojë rëndësinë e punës për begatimin e jetës personale, familjare dhe kolektive;
- ✓ të kuptojë se në ç'mënyrë sigurohen gjërat themelore për jetë si: ushqimi, veshmbathja, strehimi;
- ✓ të përshkruajë rolin e energjisë dhe elektricitetit, rolin e burimeve ujore dhe energjinë diellore për jetën dhe prosperitetin e njeriut;

- ✓ të kuptojë rëndësinë e kursimit dhe kujdesit nga konsumi i tepruar;
- ✓ të bëjë dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave;
- ✓ të japë shembuj të të mirave që ofrohen në sektorin privat dhe publik;
- ✓ të përshkruajë ndarjen e punës në shoqëri si dhe rëndësinë e saj për prodhimin dhe këmbimin e të mirave materiale dhe shërbimeve bankare.

❖ KULTURA

Kujdesi për mjedisin

Nga kategoria e Kulturës, nxënësit duhet të përvetësojnë përmbajtjet programore që kanë të bëjnë me: tokën, lumenjtë dhe ujin; mjedisin; natyrën; bimët dhe kafshët; ndotjen në tokë, ujë dhe ajër; turizmin; teknologjinë etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të përshkruajë mjedisin e tij jetësor: natyrën dhe biodiversitetin;
- ✓ t'i dijë shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ambientit jetësor;
- ✓ të njohë varshmërinë e të gjithë faktorëve ekologjikë;
- ✓ të kuptojë se faktori njeri është shkaktari kryesor i ndotjes, por edhe i pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit;
- ✓ të demonstrojë me shembuj konkretë nga jeta në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet të kujdesit dhe të mbajtjes së mjedisit jetësor.

❖ KOHA DHE NDRYSHIMET

Ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri

Nga nënkategoria Ndryshimet në Natyrë dhe në Shoqëri, nxënësit duhet të mësojnë për: ndryshimet në shoqëri dhe në natyrë; për njerëzit e njohur të vendit tonë; për jetën në fshat dhe në qytet; për komunitetin; për shtëpinë dhe shërbimet; për makinat e thjeshta; për komunikacionin

tokësor, ujqor dhe ajror; për udhëtimet dhe transportin, për historinë e informacioneve etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- ✓ të përshkruajë dhe të shpjegojë ndryshimet në shoqëri dhe në natyrën e vendlindjes;
- ✓ të përshkruajë kontributin e disa njerëzve të njohur të vendit në të kaluarën;
- ✓ të analizojë ndërveprimin e qenieve njerëzore dhe mjediseve të tyre fizike;
- ✓ t'i dallojë disa nga makinat e thjeshta që përdoren në jetën e përditshme; .
- ✓ të përshkruajë (dhe demonstrojë praktikisht) funksionimin e komunikacionit tokësor, ujqor dhe ajror;
- ✓ të përshkruajë historinë e disa informacioneve.

UDHËZIME METODIKE

Me qëllim realizimi të programit mësimor në këtë lëndë mund të organizohen takime me njerëz, mund të shfrytëzohen burime të ndryshme dhe të simulohen raste për zgjidhje, p.sh:

- Takime me njerëz të ndryshëm të komunitetit (vëzhgime, intervista, anketime - të aftësohen nxënësit si t'i përgatisin ato, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.);
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme (gazeta, buletine informacione, tekste, videokaseta, dramatizime, posterë etj.);
- Simulime (lojërat me role, simulimi i diskutimeve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.).

Përveç metodave tradicionale, në lëndën e Edukatës qytetare në shumë raste mund të zbatohet **loja me role**. Për zbatimin e kësaj forme të punës është e domosdoshme të bëhet **simulimi** i një ngjarjeje. Nxënësit marrin role, p.sh., të mësuesit, drejtorit të shkollës, prindërve, policit të qarkullimit rrugor, anëtarëve të ndryshëm të komunitetit, etj. Mësuesi në këtë rast luan rolin e koordinatorit, ndërsa të gjithë nxënësit e klasës

marrin pjesë aktive në këtë proces. Ata mund të ndahen sërish në grupe p.sh., grupi i punëtorëve që mbrojnë natyrën dhe parqet, grupi i fëmijëve që nuk respektojnë rregullat e caktuara për mjediset publike, etj. Gjatë një ore mësimi mund të debatojnë rreth asaj se si është çështja, cilat janë rrugëzgjdhjet e problemit për të cilin debatohet, etj.

Theks i veçantë në metodologjinë e punës duhet t'u kushtohet metodave aktive të punës, si: Puna me projekte, mësimi problemor, mësimi me bashkëpunim, biseda, vëzhgime, puna në mjedise konkrete (me organizata të ndryshme të komunitetit) etj.

Si forma pune, mësimdhënësve u sugjerohet të organizojnë punën në klasë me çifte dhe me grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe në grupe, u jep atyre mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast nxënësve të ndarë në çifte dhe në grupe u jepen 5 minuta kohë për të vendosur p.sh., Cili është roli i prindërve për shëndetin e fëmijëve të tyre? Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i gjithë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo në çifte, ndërsa mësuesi luan rolin e mbikëqyrësit, dhe sipas nevojës edhe jep udhëzime apo sqarime. Në përfundim të orës mësimore, çiftet apo grupet raportojnë para gjithë nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë përfaqësuesin i cili raporton para klasës.

UDHËZIME PËR VLERËSIM

Vlerësimi i nxënësve në lëndën Edukata qytetare duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumëfishta. Kështu përmes vlerësimit:

- sigurohen informacione për përparimin e nxënësit;
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me rezultatet e pritshme. Në këtë mënyrë nxënësi do të bëjë edhe vetëvlerësimin e asaj që ka arritur të zotërojë;
- sigurohet motivimi i nxënësve për punë të mëtejshme;
- sigurohet edhe realizimi i objektivave.

Llojet e vlerësimit

Në të gjitha lëndët mësimore ekzistojnë lloje të ndryshme vlerësimi. Në lëndën Edukata qytetare mund të zbatohen disa lloje vlerësimi. Secili prej tyre ka qëllime të caktuara.

Vlerësimi duhet të jetë i përhershëm, duke filluar nga orët e mësimit, veprimtaritë praktike e deri te vlerësimi përmes testeve zyrtare. Në klasë, gjatë orës së mësimit mund të bëhen këto vlerësime:

- vlerësimi i rëndomtë gjatë pjesëve të ndryshme të orës;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- vlerësimi i projekteve të realizuara individualisht ose në grup;
- vlerësimi me teste të hartuara nga vetë mësuesi.

Kriteret për vlerësimin e nxënësve janë përcaktuar qartë në Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e shkallës së arritjes së nxënësve.

QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Programi i Edukatës qytetare në klasën e katërt prek sfera të ndryshme interesimi të nxënësve, prandaj si i tillë ndërlidhet gati me të gjitha lëndët e tjera mësimore si: Gjuhë amtare, Njeriu dhe natyra, Gjuhë e huaj, Histori, Edukatë fizike, Art figurativ dhe Muzikë.

- **Gjuha dhe komunikimi** : Esetë, vjershat e posaçërisht tregimet, si dhe shkrime të tjera që për temë kanë shëndetin e njeriut (fëmijës) si dhe higjienën personale dhe higjienën në përgjithësi në programin e gjuhës dhe komunikimit janë të shumta . Këto përmbajtje natyrshëm kanë lidhje ndërlëndore me përmbajtjet programore që do të realizohen në programin e edukatës qytetare në klasën e katërt. Shëndeti dhe higjiena, mjedisi ynë jetësor, liritë, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e fëmijëve janë përmbajtje (tema) që gjerësisht trajtohen edhe në revista dhe gazeta shkollore, posaçërisht në gazetën e murit dhe revistën e shkollës, si dhe në mjete të tjera të informacionit publik të shkruara dhe elektronike.
- **Njeriu dhe natyra**: këtu trajtohen përmbajtje të ngjashme programore si: njeriu si qenie njerëzore; mjedisi natyror dhe shoqëror, zhvillimi i botës bimë dhe shtazore; kushtet e jetës; ndryshimet në komunitet, e të tjera.
- **Edukatë fizike**: E tërë përmbajtja e edukatës fizike në mënyrë të drejtpërdrejtë është e lidhur me përparimin e shëndetit të fëmijëve, prandaj kjo përmbajtje gjithsesi është shumë e lidhur me

përmbajtjen programore që zhvillohet në nënkategoritë “shëndeti”, “kujdesi për mjedisin” etj.

- **Art figurativ:** Përgatitja e materialeve ilustruese si vizatime, postere, albume, si dhe efekte të tjera vizuale për vetëdijësimin shëndetësor dhe higjienik të nxënësve, pastaj për ndërgjegjësimin ligjor, qytetar dhe mjedisor të nxënësve është një mundësi e mirë për ndërlidhje të vazhdueshme të lëndës Edukata qytetare me artet figurative. Kjo ndërlidhje mund të përdoret në tema si liritë dhe të drejtat e njeriut, rregullat e klasës, shtëpisë dhe komunitetit, etj.
- **Muzikë:** Zhvillimi i talentit për muzikë, vizatim, poezi etj., janë aspekte shumë të rëndësishme të identitetit personal. Po ashtu talenti dhe shkathësitë në artin muzikor dhe atë figurativ, recitim, aktrim etj., i ndihmojnë shumë nxënësit në njohjen e kulturës dhe të gjitha elementeve artistike si pjesë përbërëse të saj, në periudha të ndryshme kohore.

Mbetet detyrë e arsimtarit që gjatë planifikimit dhe zhvillimit të përmbajtjeve programore t’i harmonizojnë veprimet dhe të njëjtës përmbajtje programore t’i qasen njëkohësisht nga kënde të ndryshme, por komplementare që i begatojnë dhe i plotësojnë kategoritë programore që zhvillohen në klasën e katërt.

LITERATURA

1. Rojtarët e buzëqeshjes, UNICEF, 2000, Prishtinë
2. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve UNICEF, Prishtinë, 2000
3. Rozemberg. M. “Një model i komunikimit jo të dhunshëm, Prishtinë, 1996
4. Demokracia për të gjithë (doracak për mësimdhënës) edukimi për një kulturë demokratike & Kinderbeg, International,2003, Prishtinë
5. Instituti i studimeve pedagogjike, Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e edukimit qytetar, (DRAFT), Tiranë, 1997
6. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
7. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Tiranë 2000

8. Instituti i Studimeve Pedagogjike, Platforma e hartimit të standardeve të arritjes për lëndët, Tiranë, 2002
9. Grup autorësh, Strategji për të mësuarit e qytetarisë demokratike, Tiranë, 2000
10. Këshilli për bashkëpunim kulturor, koncepte dhe kompetenca themelore për edukimin për qytetari demokratike (Përkthim), Tiranë, 2000;
11. Grup autorësh “Të gjitha qeniet njerëzore...”, doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998
12. Edukimi i të drejtës për QYTETARI në Kurrikul: vështrim ndërkombëtar, Londër, 1999
13. Librat e mësuesit për edukimin qytetar, kl-1-10;
14. Standardet e Edukimit qytetar –1-10, Tiranë, 2003
15. Të gjitha botimet të edukatës qytetare për kl. 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10 të Shtëpive Botuese “Libri Shkollor” dhe “Dukagjini”
16. www.dadalo.org

EDUKATË MUZIKORE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikes në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore mundëson:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtijshëm i cili nxit interesim më të gjerë për muzikën, në të vërtetë përgatitjen për ndonjë profesion, ku muzika është pjesë përbërëse.

QËLLIMET

- Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- Të zhvillojë dhe të ngrisë muzikalitetin në vazhdimësi;
- Të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- Të edukojë për mjedis të shëndoshë tingëllor;
- Të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

- **muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:**

- Këndojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë, sipas imitimit (veshit) dhe simboleve grafike, pa dhe me shoqërim instrumental.
- Luajnë në vegla muzikore ritmike dhe melodike (popullore dhe të ORF-it)
- Njohin gradualisht shenjat e shkrimit notal muzikor (për ritëm dhe melodi) dhe i përdorin ato me vetëdije gjatë interpretimit të këngëve dhe luajtjes së pjesëve instrumentale.
- Zhvillojnë kulturën vokale (qëndrimi, frymëmarrja, artikulimi, këndimi i bukur dhe shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe në dinamikë).

- **Zhvillojnë aftësinë për dëgjim aktiv përjetues dhe analitik të muzikës**

- Vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, instrumentet muzikore dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
- Dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- Dallojnë gradacionet në temp dhe ngjyrimet dinamike gjatë këndimit dhe veprimtarive të tjera muzikore;

- **Zhvillojnë të shprehurit kreativ:**

- Nxiten për shprehje të përjetimeve dhe përfytyrimeve muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore sipas prirjeve individuale ;
- Nxiten për shprehje kreative ritmike dhe melodike në bazë të imagjinimeve tingëllore individuale.

VEPRIMTARITË MUZIKORE			
<p>I N T E R P R E T I M</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Këndojnë këngë popullore dhe artistike një e dy zërëshe (me ostinato) e ligjërojnë ritme sipas veshit (imitimit) duke përdorur simbole grafike dhe duke njohur notacionin muzikor. ▪ Në vegla muzikore (fëmijërore, të ORF-it dhe të tjera), interpretojnë shoqërimi dhe kompozime të shkurtra instrumentale me simbole dhe shenja muzikore. ▪ Kultivojnë këngën popullore ▪ Aplikojnë teknikën themelore të të kënduarit dhe luajtjes instrumentale me formësim estetik, duke përdorur simbole dhe shkrimin notal muzikor. 	<p>PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE</p> <p>MUZIKA KËNDOHET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këndojnë këngët shkollore • Koncerti i klasës • Këndojnë në familjet tona • Këndojnë në dy zëra (kanoni). • Luajnë në instrumente, shoqërojnë këngët tona • tingujt i këndojnë edhe radhë-radhë në shkallën muzikore (Shkalla C-dur dhe A-mol) <p>MUZIKA SHKRUHET ME NOTA</p> <ul style="list-style-type: none"> • Notat në pentagram caktojnë tingujt (tonet) më të lartë dhe më të ulët. • Tingujt më të gjatë dhe më të shkurtër shënohen me nota (nota katërshe, tetëshe, gjysma dhe vlera e pikës pas notës). 	<p>BURIMET ARTISTIKE:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkolla jonë – F. Ibrahim 2. Biçikleta V. Beqiri 3. Fluturojmë të dy tok 4. Himni (kombëtar) 5. Në qiellin kaltërosh. 6. Mirë se vjen o Viti i Ri 7. Ishulli jonë – M. Piperku 8. Bie bora me nxitim 9. Lulekuqja R. Rudi 10. Vallja popullore P. Badivuku 11. Vjosa – A. Bektashi 12. Gjuha e kafshëve-K. Mullai 13. Semafori 14. Unë dhe babi 15. Mollëzo 16. Në ditëlindjen e shoqes 17. Kam një shoqe <p><i>Ligjërimet</i> Kosa Zam zam bibi zam Këndo për herë</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • <i>Masat muzikore (2/4, 4/4 dhe 3/4)</i> 	<p><i>Lakuriqi natën</i> <i>Zog zog laraman</i> <i>Bjen këmbana</i> <i>Mace mace pis pispis</i> <i>Ejani flutura vasha të bukura</i></p>
<p>D Ë GJ I M</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Dëgjojnë me vëmendje kompozime të ndryshme nga muzika programore dhe absolute.</i> ▪ <i>Shprehin përshtypjet e tyre rreth përjetimit muzikor.</i> ▪ <i>Përcjellin ngjarjet kulturore në mjedisin e tyre.</i> ▪ <i>Vallëzojnë</i> ▪ <i>Dallojnë dhe njohin instrumentet muzikore ne veprat që dëgjojnë</i> ▪ <i>përjetojnë formën e këngës dypjesore - ab</i> 	<p>MUZIKA DËGJOHET</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Me muzikë në botën e imagjinatës (Muzikë baleti dhe filmi)</i> • <i>Vallëzojnë me muzikë</i> • <i>Bisedojnë dhe mësojnë për krijimin dhe interpretimin e muzikës</i> • <i>dëgjojnë muzikë dhe dhe njohim instrumentet muzikore popullore dhe të tjera (klarinetë, tromba, saksofoni kitara, violonceli, kastanjetat, lodra e vogël, defi)</i> • <i>muzika ka temp të ngadalshëm</i> 	<p><i>Schuman: Pjesë nga ciklet: Karnevali, Skenat e fëmijëve</i> <i>Çajkovski: Baleti "Arrethyesi"</i> <i>Tish Daija: Fragment nga baleti "Halili dhe Hajrija"</i> <i>K. Sen Sans: Pjesë nga Karnevali i shtazëve</i> <i>V. Beqiri "744S" Kuartet për saksofona.</i> <i>- M. Mengjiqi ("Valle") (perkusione e piano).</i> <i>- F. Qerimaj: Kabavango nr. 2 (muzikë labe, violinë, klarinetë, piano)</i> <i>R. Dhomi: (Trio harkor)</i> <i>A. Peqi: Valle (flautë e piano)</i> <i>V. Tole: Ç'u mbush mali (kor , piano)</i> <i>Donius Mildhaud: Panvera</i></p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Dallojnë tempin ngadalë - shpejt dhe accelerando e rittardando</i> 	<p><i>dhe të shpejtë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>muzika mund të jetë e qete ose e fuqishme(p,f, mf mp)</i> 	<p><i>(piano)</i> <i>Strauss: Radecky Marsh</i> <i>Schubert :Vasli skocez</i> <i>Verdi: Rigoletto (La dona e mobile)</i> <i>B. Shehu: “Lepuri me 5 këmbë”</i></p>
<p><i>K</i> <i>R</i> <i>I</i> <i>J</i> <i>I</i> <i>M</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Zgjedhin dhe përdorin tinguj (me zë ose instrumente) për t’u shprehur</i> ▪ <i>Krijojnë tërësi te reja muzikore</i> 	<p><i>ME MUZIKE SHPREHIM PERJETIME</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Me zërin tonë ose me instrumente shprehim / tregojmë / imitojmë/ , ngjarje, atmosferë, karaktere(personazhe) etj.</i> • <i>Krijojmë dhe interpretojmë ritme e melodi të reja, shoqërimi për këngët tona dhe pjesë për veglat tona muzikore</i> 	
<p><i>nxënësit gjatë gjithë aktivitetit muzikor shprehin përjetimin e tyre edhe përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe shprehjes letrare</i></p>			

UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

Edukimi muzikor në klasën IV është vazhdimësi dhe thellim i disa komponenteve mësimore, të cilat janë punuar edhe në klasët e mëparshme (1, 2 dhe 3), sidomos në pikëpamje të përjetimit të dukurive të ndryshme muzikore. Në klasën e katërt vazhdon të prijë përdorimi i simboleve grafike dhe inkuadrimi gradual e i matur i vetëdijshëm i notacionit të vërtetë muzikor për lartësitë tingëllore të sistemuara metodikisht (SOL, MI, DO, LA, FA, RE dhe SI). Kjo realizohet kur i përmbahemi parimit të përjetimit të dukurisë së re muzikore për të shkuar gradualisht kah njohja e vetëdijshme e tyre. Në këtë klasë inkuadrohet edhe njohja e vetëdijshme e shkallës muzikore si koncept, asaj C-dur dhe A-mol për të njohur dukurinë e radhitjes së tingujve muzikorë në shkallën muzikore dhe vendet e tyre në shkallë, por edhe për të vërejtur e dalluar gjinitë e kundërta tonale (dur –mol).

Me një planifikim të mirë, përmbajtjet programore nga veprimtaritë muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) të cilat u ofrohen nxënësve duhet të jenë në përputhshmëri me mundësitë e zhvillimit të tyre të përgjithshëm dhe atij muzikor në veçanti.

Mësimdhënia muzikore duhet të realizohet duke zbatuar shumëllojshmërinë në procesin mësimor në kuptim të kombinimit të veprimtarive bazë. Mësimdhënësi do të përdorë metoda dhe forma aktive të punës të cilat garantojnë sukses në procesin edukativ-muzikor.

Veprimtaritë mësimore - muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme, prandaj formulimi i njësive mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë, jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe t'u bëhet e mundshme nxënësve veprimtari aktive, në vartësi nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore mbështetur në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim.
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor.
3. Informacionet për kulturën muzikore të mjedisit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

INTEPRETIMI

Interpretimi si veprimtari themelore muzikore, që u ofrohet nxënësve, realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në vegla muzikore mbështetet në:

- Interpretimin e këngëve dhe lojërave popullore, ligjërimeve ritmike;
- Interpretimin e këngëve artistike për fëmijë;
- Njohjen e vetëdijshme të dukurive ritmike e melodike më parë të përjetuara (masat, vlerat ritmike, krahasimi i tonalitetit dur dhe mol etj.).

Në këndim zbatohet të kënduarit sipas veshit (imitimi) duke respektuar individualitetin e nxënësve dhe gradualisht aplikohet përdorimi i elementeve të notacionit të vërtetë muzikor përmes kalimit nga simbolet grafike dhe notacioni grafik (klasa III) në atë të vërtetë muzikor. Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes në ambitusin e nxënësve dhe të synojë vazhdimisht për këndim të drejtë dhe të bukur, duke respektuar pozitën e drejtë gjatë këndimit, frymëmarrjen e duhur, shqiptimin dhe artikulimin e saktë si dhe inkorporimin e ngjyrimet dinamik dhe shprehjes emocionale. Në këtë klasë i kushtohet kujdes edhe ndjenjës për formë duke nxitur nxënësit të vërejnë formën e këngëve që këndojnë dhe veprave që i dëgjojnë në kuptim të të vërejturit të tërësive të mëdha (dypjesshmërinë ose tripjesshmërinë).

Luajtja me veglat muzikore aplikohet në shoqërimin e këngëve ose e lidhur me lëvizjen dhe vallëzimin, por edhe në të shprehurit kreativ muzikor të nxënësve, duke i përdorur ato për riinterpretimin apo krijimin e tërësive të reja muzikore.

DËGJIMI

Dëgjimi muzikor në klasën e katërt si edhe më parë duhet realizuar duke iu përmbajtur objektivave të kësaj klase dhe duke synuar në dëgjim përjetues të shprehjes muzikore të veprës. Procedura metodike e dëgjimit duhet të realizohet me kujdes, duke pasur parasysh kohëzgjatjen përkatëse të veprës në funksion të përqendrimit të vëmendjes si dhe mundësinë për shprehje kreative në bazë të dëgjimit.

Dëgjimet duhet të jenë të shkurtra dhe të shpeshta. Dëgjimi i përsëritur i veprës u mundëson nxënësve të vërejnë dhe të dallojnë gjithnjë

mjete dhe elemente të reja nga shprehja muzikore. Gjatë dëgjimit duhet të insistohet në të vërejturit e mjeteve dhe formacioneve interpretuese, karakterin shprehës të veprës, ngjyrat e ndryshme tingëllore dhe elementet muzikore si ritmi, melodia, harmonia (në kuptim të diferencimit të tingëllimës në dur dhe mol). Mësimdhënësi bën përzgjedhjen e veprave për dëgjim nga shembujt e propozuar në programin mësimor, duke i ndërlidhur me përmbajtjet tematike dhe veprimtaritë e tjera (interpretimin, krijimin). Përgatitjet motivuese para dhe pas dëgjimit mundësojnë dëgjim aktiv dhe të vëmendshëm.

KRIJIMI

Aktivitetet krijuese në këtë klasë kryesisht realizohen përmes lojës kreative, e cila mbetet shfaqja më thelbësore e kreativitetit të tyre.

Lëvizja dhe vallëzimi paraqesin aktivitetet bazë përmes të cilave nxënësit shprehin përjetimet e tyre muzikore por inkurajohet edhe shprehja figurative dhe gjuhësore e mbështetur në inspirimin nga muzika e dëgjuar. E rëndësishme është sidomos forma e të shprehurit muzikor; bisedat muzikore (pyetjet e përgjigjet muzikore që realizohen me zë ose me vegla muzikore), improvizimet meloritmike të ndryshme dhe krijimi i tërësive të reja muzikore.

Në këtë formë posaçërisht mësimdhënësi inkurajon nxënësit dhe i këshillon ata, por u siguron lirinë e nevojshme për këtë veprimtari muzikore. Ai shënon dhe konservon (incizon, memorizon) krijimet e tyre dhe i nxit për vlerësim kritik të punës së tyre dhe të nxënësve të tjerë, duke i caktuar kriteret sa më të kuptueshme për një vlerësim të tillë.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor sipas kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore, shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndieshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet sipas përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar, gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara,
- këndimi dhe luajtja instrumentale,
- diktimet melodike dhe ritmike,
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim,
- prezantimi,

Instrumente të tjera të vlerësimit janë:

- testi,
- vetëvlerësimi.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe sipas interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë interpretimi muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe me orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore edhe në nivelin e shkollës fillore (kori i ciklit të ulët - dhe ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 2 orë). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kriterë artistike – pedagogjike.

EDUKATË FIGURATIVE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJE

Edukata figurative e klasës së katërt, u mundëson nxënësve që edhe më tutje t'i zhvillojnë njohuritë e përgjithshme dhe ato të veçanta në kuptimin e pamjeve në natyrë dhe gjenerimin e tyre në trajta artistike. Zhvillimi kulturor i nxënësve përfshin aftësinë e përgjegjes së përshtatshme ndaj vlerave estetike të shoqërisë sonë dhe kërkesave të tjera në procesin edukativo-arsimor.

- Kjo lëndë, gjithashtu u mundëson nxënësve gjenerimin e ideve të reja, sugjerimin dhe mundësinë e rrugëve inovative dhe ndikon pozitivisht në kuptimin e marrjes së vendimeve në situata të perceptuara vizualisht.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së Edukatës figurative të klasës së katërt ka për qëllim hetimin, hulumtimin, zhvillimin e ideve, arritjet e përfundimeve, realizimin dhe vlerësimin e punës kreative. Nxënësit këtë vit shkollor, do të hulumtojnë dhe përdorin materiale dhe procese të ndryshme pune, duke komunikuar me idetë dhe domethëniet e tyre me qëllim lehtësimi të njësive mësimore gjatë krijimeve figurative.

- Nxënësit i mbledhin informatat verbale e pamore të mësuara më parë dhe i dallojnë veçoritë e materialeve dhe proceseve të punës, duke i kombinuar dhe organizuar këto cilësi pamore në taktilitet të përshtatjes së qëllimeve të tyre.

OBJEKTIVAT

E përgjithshëm	Specifikë
<i>Nga përmbajtja programore e klasës së katërt, nxënësi do të jetë në gjendje:</i>	
➤ Të hulumtojë	<ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë pamore dhe taktile të materialeve dhe proceseve. • Idetë dhe metodat e qasjeve të reja.
➤ Të zgjerojë njohuritë	<ul style="list-style-type: none"> • Nga puna praktike dhe përdorimi i teknikave. • Në fushat e ndryshme të artit figurativ.
➤ Të krahasojë	<ul style="list-style-type: none"> • Përvojat personale të punës së tij dhe të tjerëve. • Dallimin e përparësive dhe të metat e punës së njëri-tjetrit. • Punimet figurative gjatë vizitës në muze apo galeri arti.
➤ Të aplikojë	<ul style="list-style-type: none"> • Përvojat shprehëse ndaj mjeteve dhe teknikave punuese.
➤ Të debatojë	<ul style="list-style-type: none"> • Rreth qasjeve dhe ideve të propozuara. • Për vlerësimin e punimeve sipas përvojave personale.
➤ Të komunikojë	<ul style="list-style-type: none"> • Me shenja vizuale dhe art të aplikuar. • Për imagjinatën kreative dhe punimet nga fusha e artit.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë
I. Të vërejturit dhe njohuritë	1. Perspektiva në hapësirë..... 3 orë 2. Baraspesha e formave..... 3 orë 3. Shtrirjet e sipërfaqeve.....3 orë
II. Të shprehurit dhe kreativiteti	1. Vijat dhe llojet e vizatimit.....8 orë 2. Ngjyrat dhe ndikimi i tyre.....8 orë 3. Kontrasti me dritë-hije..... 2 orë
III. Analiza dhe vlerësimi	1. Veçoritë e degëve të artit figurativ.....6 orë 2. Komunikimi.....2 orë ▪ Orë të zgjedhura2 orë

I. Të vërejturit dhe njohuritë

- Udhëzim: Aftësimi i nxënësve gjatë procesit të mësimit në vrojtim të perspektivës hapësinore, formave të baraspeshuara dhe shtrirjeve sipërfaqësore gjatë shtjellimit të punëve kreative.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> • Perspektiva në hapësirë (3 orë) 	<p>Njohtimi dhe zgjedhja e temave nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Perspektiva hapësinore; Shpjegimi dhe puna praktikë me nxënës me shembuj praktik siç janë: shtyllat elektrike, binarët e trenit etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Vizatim dhe ngjyrosje-3orë, (lapsi i butë, ngjyra e druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillojnë aftësinë për pamjet e perspektivës në hapësirë; • Vizatojnë dhe ngjyrosin punime nga perspektiva hapësinore;
<ul style="list-style-type: none"> • Baraspesha e formave (3 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Kujdesi në vendosjen e formave sipas baraspeshës; (p.sh. Një formë e madhe e vizatuar në të djathtë të fletës u kundërpërgjigjet disa formave më të vogla në të majtë ose formës së madhësisë së njëjtë). 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Vizatim dhe ngjyrosje-2orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Modelim-1 orë, (plastelinë, letër me ngjyra, tekstil etj.)</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëjnë dallimin dhe krahasimin e baraspeshës së formave. • Shprehen me punime të formave të baraspeshuara.
<ul style="list-style-type: none"> • Shtrirjet e sipërfaqeve (3 orë) 	<p>Krahasimi i sipërfaqeve të ndryshme dhe punimi i ndonjë shembulli në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Shtrirjes së sipërfaqeve në hapësirë; (Të pjerrta, të rrafshta, të valëzuara etj). 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Vizatim dhe ngjyrosje-2orë, (lapsi i butë, ngjyra e druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Kolazh -1 orë ngjitja e letrave shkëlqyese, fjetet e shkrepësës, kokrra orizi ose fasule etj.</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallojnë dhe punojnë shtrirjet e sipërfaqeve në hapësirë. • Pikturojnë e kolazhojnë një punim tematik.

II. Të shprehurit dhe kreativiteti

- Udhëzim: Të shprehurit dhe kreativiteti të nxënësit e kësaj moshe pasqyrohet përmes punës kreative nga motivet e zgjedhura për krijim gjatë përdorimit të mjeteve shprehëse në detyrat hulumtuese. Vazhdimi i përvojës në vizatim, ndikimi emocional i ngjyrave dhe efekteve të tjera realizuese janë pjesë kompakte e kësaj kategorie.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> • Vijat dhe llojet e vizatimit (8 orë) 	<p>Përcaktimi i temave të zgjedhura në bazë të vijave dhe modeleve për vizatim sipas llojeve të vizatimit: kroki, skicë dhe analitik si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peizazh; • Natyrë e qetë; • Portret; • Formë e aplikuar; 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Vizatim 6 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Modelim-2 orë, (plastelinë, shkopinj, tel i butë etj.)</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallojnë llojet e vijave dhe të vizatimit. • Vizatojnë peizazhe, natyrën e qetë dhe portrete nga modelet e zgjedhura. • Shprehen me vija, ngjyra e mjete të tjera krijuese gjatë aplikimit të formave të zgjedhura.
<ul style="list-style-type: none"> • Ngjyrat dhe ndikimi i tyre (8 orë) 	<p>Njohja dhe përshtatja e temave në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Natyrës së ngjyrave: Manifestimi i ngjyrave në psikologjinë e njeriut: - Ngjyra e verdhë, e portokalltë dhe e kuqe, reflektojnë ngrohtësi, hare etj. - Ngjyrat e nuancave: të gjelbërtës dhe të kaltërtës paraqesin ftohtësi, qetësim etj. - Llojeve të ngjyrave: (druri, pastele, uji, tempere etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Vizatim e ngjyrosje- 6 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji, ngjyra pastele etj.)</i> ○ <i>Modelim-2 orë, (plastelinë, shkopinj, gurë të vegjël, letër me ngjyra etj.)</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbajnë në mend pasqyrimin e ngjyrave. • Përfitojnë shkathësi krijuese me anë të ngjyrave. • Veçojnë dhe krijojnë punime nga llojet e ngjyrave.

<ul style="list-style-type: none"> • Kontrasti me dritë-hije (2 orë) 	Ushtrime praktike për realizimin e një punimi me dritëhije. <ul style="list-style-type: none"> • Natyrë e qetë. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>(përdorimi i ngjyrave, mjeteve të tjera për vizatim apo materialeve të tjera) - 2 orë.</i> 	Nxënësit do të: <ul style="list-style-type: none"> • Shprehen me punime kreative me ngjyra.
--	--	---	--

III. Analiza dhe vlerësimi

- Udhëzim: Kjo kategori, këtë vit shkollor shtron nevojën e njohurive të para për veçoritë e degëve të artit pamor si dhe rrit aftësinë e komunikimit masiv në relacione të ndryshme kohore e pamore.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë e degëve të artit figurativ (6 orë) 	Njohja me ndarjet dhe veçoritë e artit pamor: <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë e Artit figurativ: (Vizatimi, Piktura, Skulptura, Grafika). • Veçoritë e Artit të aplikuar: (Dizajni grafik, Dizajni industrial, Qeramika, Tekstili). 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Mësim teorik për ndarjen dhe veçoritë karakterizuese të artit-2 orë.</i> ○ <i>Demonstrim konkret dhe punë praktike me shembuj nga fusha e artit figurativ e aplikativ-4 orë, (demonstrim me punime, fotografi, fotosllajde, internet etj).</i> 	Nxënësit do të: <ul style="list-style-type: none"> • Tregojnë ndarjen dhe veçoritë e artit figurativ. • Të jenë në gjendje të bëjnë dallimin e punimeve të artit figurativ sipas degëve.
<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi (2 orë) 	Njohja dhe komunikimi në bazë të: <ul style="list-style-type: none"> ❖ Shenjave dhe simboleve; (shenjave në rrugë, dhe mjete të tjera komunikuese si në; libra, revista, posterë, simbole etj.) ❖ Pamjeve të lëvizshme; (reklammat televizive, filmat e vizatuar, interneti etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Rikrijimi i shenjave, simboleve sipas zgjedhjes së lirë – 1 orë; (laps ose ngjyrat e zgjedhura).</i> ○ <i>Punime të shenjave e simboleve-1 orë; (plastelinë, tel i butë, shkopinj, letra të ndryshme etj.).</i> 	Nxënësit do të: <ul style="list-style-type: none"> • Komunikojnë dhe shprehen me shenja dhe simbole në bazë të kreativitetit.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

- Edukata figurative ka qasje ndërlëndore e programore, me të gjitha lëndët e tjera mësimore. Përshkrimet ilustrative në tekste dhe mjete të tjera mësimore, u ndihmojnë nxënësve t'i kuptojnë më lehtë njësitë mësimore.
- Kjo lëndë ka qasje kryesore ndërlëndore e programore me gjuhën shqipe, matematikën, njeriun dhe natyrën, punë-doren, muzikën, edukimin qytetar, edukatën fizike.
- Edukata figurative është lëndë gjithpërfshirëse dhe përmes saj, të kuptuarit logjik mund të aplikohet në procesin mësimor dhe përmes imazheve figurative vetëdijëson nxënësit: për të drejtat e fëmijëve, ruajtjen e mjedisit, të drejtat gjinore, të drejtat racore, trafikimin njerëzor dhe dukuritë e tjera negative.

UDHËZIME E REKOMANDIME PËR PUNË PRAKTIKE

- Mësimdhënësi duhet të jetë aktivë gjatë orës mësimore me nxënësin në qendër, në mënyrë që të vëzhgojë dhe të korrigjojë aktivitetin e nxënësve dhe punën e tyre kreative.
- Shkolla duhet të sigurojë së paku hapësirën ekspozuese për punimet më të suksesshme të nxënësve, në mënyrë që inspirimi dhe motivimi për pjesëmarrje në këto përvoja të mbështetet në suksese dhe aktivitete të larmishme.
- Aplikimi i punës individuale dhe në grupe do t'i motivojë nxënësit për bashkëpunim, tolerancë e disiplinë kolektive.
- Gjatë punës me nxënës, do të ketë dallime evidente në kuptimin e talentit të tyre, por mësimdhënia pedagogjike me udhëzime e rekomandime praktike do t'i inspirojë edhe nxënësit më pak të talentuar, në mënyrë që të mos bëhet demoralizimi dhe shkëputja e tyre nga lënda mësimore.
- Mësimdhënësi, duhet të jetë aktiv gjatë orës mësimore me nxënësin në qendër, në mënyrë që të vëzhgojë dhe të korrigjojë aktivitetin e nxënësve dhe punën e tyre kreative.
- Mësimdhënësi dhe shkolla duhet të angazhohen për pajisjen e kabineteve (klasëve), me vegla e mjete konkretizimi. Sa më të

pajisura që të jenë këto kabinete ose klasë, aq më të suksesshme do të jenë rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

- ❖ Vlerësimi i rregullt dhe matja e kujdesshme e përparimit të nxënësve gjatë mësimit figurativ nxit dhe motivon përkushtimin e tyre më të madh në arritjen e rezultateve sipas objektivave të parashtruar.
- ❖ Meqenëse vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë kryesisht bëhet duke u mbështetur në komunikimin e tyre verbal, mësuesi duhet të ketë parasysh edhe angazhimin e nxënësve për zhvillimin e njohurive të tjera nga fjalori figurativ ose komentimin e dukurive të tjera hapësinore.
- ❖ Për këtë lëndë, vlerësimin objektiv duhet kërkuar në bazë të arritjeve nga:
 - Kreativiteti individual i shprehjes së lirë në zotërimin e trajtave më të sakta nga detyrat e parashtruara;
 - Aktiviteti dhe përfshirja e nxënësve në punë individuale dhe grupore ose ekspozita të ndryshme (shkollore);
 - Origjinaliteti dhe qasja përkushtuese në përfundimin e punimeve;
 - Njohja e drejtimeve të artit figurativ dhe veçoritë e tij, si dhe komunikimi verbal për termat, dukuritë dhe analizat tematike etj.

TEKSTET DHE MJETET E TJERA MËSIMORE

Me qëllim lehtësimi të procesit mësimor, përveç teksteve mësimore nevojiten edhe:

Mjetet dhe materiali mësimor si:

- Revista, fotografi, ilustrime, simbole, posterë, piktura etj.
- Fotosllajde, kompakt disqe (CD), kaseta etj.
- Adresa në internet (www.art-attack.com www.toggo.de).

- Modele të ndryshme (lojëra, kukulla-modele, maketa, forma gjeometrike etj.).
- Lloje të letrave me gramaturë e ngjyra të ndryshme.
- Lloje të ngjyrave (lapsa, akuarel, temper, pastel etj.).
- Brushë, ngjitës, gërshërë, plastelinë, kocka të ndryshme, sapunë, tel të butë, lloje të tekstileve etj.

PUNËDORE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJE

Punëdore për klasën e katër është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme (trafiku, prodhimet bujqësore, teknologjia e materialeve ndërtimore, pajisjet teknike, modelimi me materiale dhe teknologjia e përpunimit të qumështit) që parashihen për këtë nivel. Lënda e punës së dorës ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke zhvilluar aftësinë e tyre krijuese si dhe ato komunikuese.

Lënda ndihmon në formimin dhe në zhvillimin e koncepteve, si në punën e dorës, ashtu edhe në lëndë të tjera mësimore që zhvillohen në shkollë. Puna e dorës shërben edhe si mjet për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të punës së dorës të nxënësit janë:

- Zhvillimi i një shprehje pozitive të nxënësit ndaj shprehisë në punëdore dhe rëndësisë së saj.
- Familjarizimi me mjedisin dhe motivimi i nxënësve që njohuritë e nxëna t'i shfrytëzojnë në jetë.
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë ndonjë nisativë dhe veprim të pavarur, duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grupe, në vartësi nga llojet e ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM:

Nxënësi duhet:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.
- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullneshëm, kritik, me nisëtiavë, etj.)

Të kuptojë

- Rëndësinë e përdorimit të materialeve ndërtime.
- Rëndësinë ushqyese të frutave dhe të perimeve.
- Rëndësinë ushqyese të qumështit dhe të produkteve të tij.

Të përshkruajë

- Mënyrën e përdorimit të aparateve kryesore shtëpiake.
- Mënyrën e përpunimit teknologjik të: qumështit, kosit, djathit dhe gjalpfit.

Të zbatojë

- Rregullat e përdorimit të aparateve kryesore shtëpiake.
- Rregullat e sjelljes së këmbësorit në trafik.

Të dallojë

- Pajisjet e ndryshme shtëpiake.
- Llojet e qepjes në pëlhurë.

Të demonstrojë

- Procesin e përgatitjes së ushqimeve.
- Përfitimn e kosit, djathit dhe gjalpfit.

Të modelojë

- Objekte nga gjysmëprodhimet e drurit.
- Me qepje, thurje e qëndisje.

Të demonstrojnë shkathtësi mendore

- Të ketë besim në vetvete dhe të rritë besimin në aftësinë e tij për punë artizanale.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Trafiku	1.1 Rregullat e sjelljes së këmbësorit në trafik	6	16,21 %
2. Prodhimet bujqësore	2.1 Teknologjia e prodhimeve bujqësore	8	21,63 %
3. Teknologjia e materialeve ndërtimore	3.1 Druri në ndërtimtari 3.2 Guri, rëra dhe zhavori	8	21,63 %
4. Pajisjet teknike	4.1 Përdorimi i pajisjeve shtëpiake	2	5,40 %
5. Modelimi me materiale	5.1 Modelimi me materiale të ndryshme si: qepja, thurja dhe qëndisja	8	21,63 %
6. Teknologjia e përpunimit të qumështit	6.1 Qumështi 6.2 Kosi 6.3 Djathi 6.4 Gjalpi	5	13,51 %

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
1. Trafiku	1.1 Rregullat e sjelljes së këmbësorit në trafik	1.1.1 Rregullat e këmbësorit. 1.2.2 Rregullat e mirësjelljes në autobus. 1.3.3 Llojet e shenjave: shenjat urdhëruese, të rrezikut, të lajmërimit dhe të dritës.	<i>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</i> Të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e komunikacionit për këmbësorë. Të tregojë dhe të zbatojë rregullat e mirësjelljes në autobus. Të emërtojë dhe të klasifikojë shenjat themelore urdhëruese, të rrezikut, të lajmërimit dhe të dritës.	Gjuhë amtare, Matematikë
2. Prodhimet bujqësore	2.1 Teknologjia e prodhimeve bujqësore	2.1.1 Konservimi i frutave. 2.1.2 Konservimi i perimeve. 2.1.3 Përgatitja e ushqimit.	Të emërtojë llojet e pemëve dhe të perimeve dhe të përshkruajë teknologjinë e konservimit të tyre. Të kuptojë rëndësinë ushqyese të frutave dhe të perimeve. Të zbatojë dhe të demonstrojë procesin e përgatitjes së ushqimeve.	Gjuhë amtare, Njeriu dhe natyra.
3. Teknologjia e materialeve ndërtimore	3.1 Druri në ndërtimtari	3.1.1 Druri material për ndërtimtari. 3.1.2 Përdorimi i ndryshëm i drurit në ndërtimtari.	Të emërtojë llojet e drurit që përdoren në ndërtimtari. Të identifikojë zbatimet e ndryshme të drurit në ndërtimtari. Të modelojë objekte nga gjysmëprodhimet e drurit.	Gjuhë amtare, Arte të bukura.
	3.2 Guri, rëra dhe zhavori	3.2.1 Përdorimi i gurit, i rërës dhe i zhavorit në ndërtimtari.	Të identifikojë përdorimin e gurit, të rërës dhe të zhavorit në ndërtimtari.	

4. Pajisjet teknike	4.1 Përdorimi i pajisjeve shtëpiake	4.1.1 Përdorimi i aparateve të ndryshme shtëpiake: shporetit elektrik, nxehëses, tharëses së flokëve, televizorit, telefonit.	Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të aparateve kryesore shtëpiake. Të zbatojë rregullat e përdorimit të tyre. Të dallojë pajisjet e ndryshme shtëpiake.	Gjuhë amtare, Matematikë.
5. Modelimi me materiale	5.1 Modelimi me materiale të ndryshme si: qepja, thurja dhe qëndisja	5.1.1 Llojet e qepjes në pëlhurë: shpuarja me kthim dhe zigzake. 5.1.2 Qepja e pullave dhe hapja e vrimës për pulla. 5.1.3 Thurja me një kërrabëz. 5.1.4 Thurja me dy kërrabëza. 5.1.5 Llojet e qëndisjes.	Të dallojë llojet e qepjes dhe t'i zbatojë në jetën e përditshme. Të jetë në gjendje të qepë pulla dhe të hapë vrima për pulla. Të thurë me një dhe dy kërrabëza. Të qëndisë. Të modelojë me qepje, thurje dhe qëndisje.	Gjuhë amtare, Matematikë, Arte të bukura.
6. Teknologjia e përpunimit të qumështit	6.1 Qumështi	6.1.1 Përfitimi dhe grumbullimi i qumështit. 6.1.2 Përpunimi teknologjik i qumështit.	Të tregojë nga përfitohet qumështi. Të përshkruajë mënyrën e përpunimit teknologjik të qumështit.	Gjuhë amtare, Njeriu dhe natyra.
	6.2 Kosi	6.2.1 Mënyra shtëpiake dhe industriale e përfitimit të kosit.	Të demonstrojë përfitimin e kosit. Të përgatisë kos dhe të përshkruajë procesin e prodhimit të kosit.	
	6.3 Djathi	6.3.1 Llojet e djathit. 6.3.2 Mënyra shtëpiake dhe industriale e përfitimit të djathit.	Të identifikojë llojet e ndryshme të djathit. Të përshkruajë dhe të demonstrojë procesin e prodhimit të djathit.	
	6.4 Gjalpi	6.4.1 Mënyra shtëpiake dhe industriale e përfitimit të gjalpit.	Të përshkruajë dhe të demonstrojë prodhimin e gjalpit.	

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxëniet bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore;
2. Vlerësimi i punës individuale;
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore.

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. Doracakë për punën me letër dhe karton, prodhimet bujqësore, njohja nga rreziqet, ndotja e mjedisit etj.
2. **Erich Neuwirth**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 2”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2001.
3. **Schoiswohl · Jeide · Neuwirth** : “Spaß beim Forschen und Entdecken 3”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2002.
4. **Schoiswohl · Jeide · Vogl**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 4”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2003.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Trajnime për arsimtarë;
2. Kabineti i pajisur me materiale dhe mjete konkretizimi.

Kushtet minimale

1. Trajnime për arsimtarë.

UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME

1. Qasja problemore në paraqitjen e temës/njësisë;
2. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore;
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i dijes dhe i shkathëtësive, puna interaktive.

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale.

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Edukimi trupor është proces i pandashëm për begatimin e diturive, të shkathtësive dhe të shprehive lëvizore (motorike) për këtë arsye këtij lëmi duhet kushtuar kujdes dhe vëmendje të posaçme, sidomos gjatë aplikimit dhe organizimit të mësimit të edukatës fizike dhe sportive më nxënësit e klasës së katërt (IV).

Vlera dhe rëndësia e saj vërehet edhe nga aspekti i shumëfishtë e në radhë të parë në atë të ruajtjes dhe kultivimit të shëndetit të nxënësve. Duke e organizuar në bazë të kërkesave-parimeve dhe rregullave që rrjedhin nga parimet, duke iu përmbajtur formave organizative si dhe metodave të punës e me shfrytëzimin e drejtë të mjeteve dhe të rekuizitave ndihmëse mësimore, mësimdhënësi i mësimit klasor do të arrijë që me përpikëri të realizojë objektivat e këtij lëmi.

Të mësuarit e diturive, të shkathtësive dhe të shprehive lëvizore kërkojnë nivel të caktuar të cilësive psiko-fizike të nxënësve. Veprimet lëvizore që janë të parapara me Programin për nxënës të klasës IV-të mund të realizohen dhe të kenë ndikim pozitiv në transformimin e organizmit të nxënësit në ato raste kur ata kanë nivel të caktuar zhvillimi të shpejtësisë, shkathtësisë, forcës e qëndrueshmërisë. Prandaj nga nxënësit e kësaj klase si dhe nga mësimdhënësit kërkohet që në vazhdimësi, duke filluar nga klasa e parë, ta përcjellin dhe të njohin nivelin e aftësive fizike të tyre në bazë të cilave do të duhet të bëhet zgjedhja dhe planifikimi i detyrave – ushtrimeve lëvizore.

QËLLIMI

Me hartimin dhe me përfshirjen e përmbajtjeve programore në planin dhe programin mësimor është paraparë që të arrihet:

- që nxënësit të krijojnë shprehi lëvizore;
- të arrihet harmonizimi në mes të aftësive lëvizore dhe atyre funksionale të organeve të organizmit të nxënësve;
- të arrihet në vazhdimin e zhvillimit dhe përsosjes së aftësive kreative, sidomos nëpërmes lojës;
- të kultivohet dhe të ruhet të mbajturit e drejtë të trupit;
- të arrihet vetëdija dhe gatishmëria për përvetësimin më cilësor të veprimeve lëvizore;
- të arrihet përjetimi i këndshëm gjatë dhe pas zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor nga ky lëmë;
- të arrihet botëkuptimi i drejtë i respektimit të të arriturave kulturore dhe shoqërore;
- të arrihet krijimi i shprehive për veprimtari humane si dhe inkurajimi i tyre për veprim të pavarur.

OBJEKTIVAT

Duke u mbështetur në aparatën metodikë të cilën trajton nxënësit sipas diferencimit të aftësive në Planin dhe programin mësimor për nxënës të klasës IV, janë paraparë ato përmbajtje programore që duke u shfrytëzuar të arrihen këta objektiva:

- *zhvillimi trupor dhe i aftësive lëvizore dhe funksionale;*
- *fitimi, përsosja e lëvizjeve natyrore dhe diturive sportive;*
- *Përvetësimi i vetive teorike të mësimin të edukatës fizike dhe sportive;*
- *Përjetimi i këndshëm gjatë shfrytëzimit të edukimit fizik dhe sportiv.*

Zhvillimi trupor dhe i aftësive lëvizore dhe funksionale

- më lëvizje të zgjedhura të ndikohet në ruajtjen dhe në kultivimin e të mbajturit të drejtë të trupit;
- të vazhdohet ndikimi maksimal në zhvillimin e aftësive motorike, duke shfrytëzuar format e ndryshme të përmbajtjeve programore si dhe formave të punës;

- zhvillimi i aftësive psiko-motorike (koordinimi, shpejtësia, forca, lëvizshmëria, drejtpeshimi, preciziteti-saktësia etj);
- zhvillimin e aftësive funksionale të organeve të organizmit të nxënësit, duke u adaptuar në ngarkesat e ndryshme trupore-fiziologjike, mendore dhe psikike.

Fitimi, përsosja e lëvizjeve natyrore dhe diturive sportive:

- Më përmbajtje të zgjedhura të ndikohet në krijimin e bazës për përvetësimin e mëtejshëm të lëvizjeve që do të shërbejnë për përsosjen dhe perfeksionimin e diturive sportive;
- njohja me pozitat e trupit dhe marrja e tyre në formë të pavarur;
- njohja dhe përvetësimi i elementeve bazë nga përmbajtjet programore (lëvizjet natyrore, atletika, sportet, gjimnastika sportive etj);
- njohja dhe përvetësimi tekniko-taktik i lojërave themelore dhe sportive;
- njohja dhe përvetësimi i lojërave kreative si dhe të atyre themelore dhe ritmike;
- njohja dhe përvetësimi i teknikave të aktiviteteve të tjera trupore (not, ski, bjeshkatari, piknik etj.), si dhe adaptimi i organizmit të tyre në kushte të tilla.

Përvetësimi i vetive të njohurive teorike të mësimin të Edukatës fizike

- njohja e mjeteve dhe e rekuizitave, nocionet dhe shfrytëzimi i tyre;
- njohja e nocioneve themelore nga lëmi;
- njohja e vlerave dhe rëndësia e aktiviteteve sportive;
- njohja dhe aplikimi i rregullave themelore të lojërave sportive;
- njohja dhe aplikimi ritmik i lëvizjeve të përditshme;
- të fitohet dhe të kuptohet rëndësia e veshmbathjes sportive;
- të njihen dhe të respektohen kushtet në të cilat shfrytëzohen-zhvillohen aktivitetet në ujë dhe në borë.

Përjetimi i këndshëm gjatë shfrytëzimit të edukimit fizik dhe sportiv

- zhvillimi i vetëdijes mbi rëndësinë e edukimit sportiv;
- zhvillimi dhe krijimi i bazës për motivimin e nxënësve për bashkushtrim dhe lojë;
- zhvillimi i shprehive higjienike që i takojnë lëmit të edukimit trupor, pastrimi pas ushtrimeve, pastrimi i vendushtrimit si dhe mjeteve dhe rekuizitave që shfrytëzohen
- që nëpërmes aktiviteteve të ndryshme trupore të arrihet përjetimi i këndshëm, të fitohen shprehi në aspektin e vetëbesimit, shpirtit luftarak, qëndrueshmërisë shpirtërore si dhe përjetimi estetik dhe ritmik.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. orëve %
1. Lëvizjet natyrore	Lojërat dhe lëvizjet për zhvillimin e aftësive psiko-fizike lojërat themelore me ndikim edukativo-arsimor	10 orë –13%
2. Atletikë	- vrapimet, - kërcimet, - hedhjet.	20 orë – 27%
3. Gjimnastika sportive dhe ritmike	- akrobatikë, - kërcime, - hekuri, - trari, - paralelet, - unazat.	20 orë – 27%
4. Vallëzim	Ushtrime ritmike dhe vallet popullore dhe moderne	5. orë – 7%
5. Lojërat sportive	- basketboll, - hendboll, - volejball, - futboll, - pingpong, - tenis.	10 orë – 13,0%
6. Aktivitetet e tjera:	- ushtrimet e formimit, - verimi - dimërimi - pikniku	10 orë –13%

TREGUESIT THEMELORË TË PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore	Standardet e arritshmërisë
Lëvizjet natyrore	Ecjet dhe vrapimet. Lojërat themelore	Ecjet dhe vrapimet në forma të ndryshme dhe nga pozitat e ndryshme. Lojërat themelore për zhvillimin e aftësive psiko-motorike (forcës, shpejtësisë, baraspeshës, qëndrueshmërisë, për hyrje në punë, lëvizshmëri, qetësim dhe për ndikim në aftësitë funksionale të organizmit të nxënësit.	Nxënësit duhet: Të njoftohen me vlerën dhe rëndësinë e aftësive fizike, përgatitjen për jetë të shëndoshë dhe bashkëkohore si dhe lidhshmërinë e edukatës fizike me lëndët e tjera (gjuhë, muzikë dhe matematikë).
Atletikë	Ecje dhe vrapim Kërcimet Lojërat e stafetës	Ecje dhe vrapim në largësi dhe me temp të ndryshuar. (ecje me temp mesatar nga 2 minuta me pushim 1m.) - përsosja e teknikës së vrapimit të shpejtë nga starti i lartë dhe i ulët. - vrapim i shpejtë në largësi 40-60 m. - Kërcim së larti teknika „gërshëre“ - kërcim së gjati teknika “mbledhur“ - loja e stafetës me shkopinj, me rrathë, shishe druri, shkopinjth.	Të përvetësojnë nocionet themelore si dhe teknikat e ekzekutimit të përmbajtjeve programore nga atletika (si starti i ulët, i lartë, caku-arritja, shtegu, këmba shtytëse etj.) si dhe lidhshmëria e njësive mësimore me lëndët e tjera. Vlera e atletikës në transformimin e organizmit të nxënësit rregullat themelore nga atletika.
Gjymnastika sportive dhe ritmike	- ushtrime në dysHEME - kërcimet - ushtrime në	- Kapërdimi para nga pozitat e ndryshme. - kapërdimi mbrapa nga pozitat e ndryshme. - vertikalia mbi duar (me ndihmë). - kapërdim fluturimthi. - Kërcim i kaluqit me këmbë hapur. - varje në unaza.	Të kuptojnë dhe të përvetësojnë drejt pozitat fillestare nga të cilat duhet ekzekutuar ushtrimet. Vlerën e përmbajtjeve programore për t'i përvetësuar si dhe për gara. Përvetësimi i teknikave të ekzekutimit si dhe të rregullave

	<p>veglat gjymnastikore.</p> <p>- ushtrime në trarin</p> <p>- ushtrime ritmike dhe vallet popullore</p>	<p>- varje e përzier në hekur ballor (nëngjunjë).</p> <p>- mbështetje mbi duar, lëkundje dhe dalje nga lëkundja mbrapa në paralelen ballore (meshkujt).</p> <p>- Ushtrime në paralelen e shkallëzuar-femrat.</p> <p>- ecje dhe vrapim nëpër trarin.</p> <p>- ecje duke e kombinuar me kërcime.</p> <p>- ecje, vrapim, kërcim dhe kthim për 180° dhe 360°.</p> <p>- ecje kalim në ekuilibrin ballor-ecje vrapim dalje me trup në hark.</p> <p>- ushtrime ritmike me rekuizita</p> <p>- lojërat themelore me elemente ritmike.</p> <p>- vallja popullore nga rrethi shkollor si dhe vallja „dallëndyshet“</p>	<p>themelore dhe nocionet themelore sidomos të ritmit, tempit dhe dinamikës së ekzekutimit të ushtrimeve.</p>
Lojërat sportive	<p>Basketboll,</p> <p>hendboll</p> <p>volejball</p>	<p>- driblimi-udhëheqja e topit,</p> <p>- pasimi dhe prenimi i topit nga pozitat e ndryshme (vend-lëvizje)</p> <p>- lojërat e stafetës me elemente të teknikës së basketbollit,</p> <p>- loja në një kosh 1:1,2:2.</p> <p>Udhëheqja, pasimi dhe pranimi i topit, gjuajtja-trehapshi;</p> <p>- lojërat themelore duke zbatuar teknikën e elementeve të përvetësuara;</p> <p>- mbulimi dhe ç'mbulimi i lojtarit. Loja 2x 5minuta.</p> <p>- lojërat themelore për reagim të shpejtë;</p>	<p>Përvetësimi i teknikës dhe i nocioneve themelore të lojërave sportive si dhe të rregullave themelore të lojërave për organizimin dhe zhvillimin e garave sportive (basketboll, hendboll, volejball dhe futboll).</p>

	futboll	<ul style="list-style-type: none"> - pranimi dhe dëbimi i topit; Shërbimi dhe gjuajtja; - Loja 2:2- - Udhëheqja-driblimi, pasimi dhe pranimi i topit, lojërat themelore dhe të stafetës duke i zbatuar rregullat themelore të lojës së futbollit 	
Aktivitetet e tjera	Ushtrime formimi, - shëtitjet, fushimi: - dimërimi - verimi	<ul style="list-style-type: none"> - ushtrime formimi pa dhe me rekuizita për pjesën përgatitore të orës - tri shëtitje gjatë vitit shkollor (vjeshtë, dimër dhe pranverë) - orientim sipas rrugës së shënuar 7-10 ditë- - lojëra themelore në borë - rrëshqitja më saja dhe ski nëpër terren të përshtatur dhe në forma të ndryshme; - pastrimi, përgatitja e rekuizitave për lojë dhe për rrëshqitje. 7-10 ditë në verime: ushtrime për adaptim në rezistencën e ujit, - lojërat themelore, - përvetësimi i një apo dy teknikave të notit-teknika e veprimit të këmbëve, krahëve, të frymëmarrjes. - koordinimi i veprimit të përbashkët të këmbëve, krahëve dhe frymëmarrjes, starti shkollor dhe kthimi shkollor 	<p>Që nxënësit të kuptojnë dhe të përvetësojnë ato aktivitete të cilat do të mund t'i shfrytëzojnë në çdo kohë dhe moment kur paraqitet nevoja, dhe të cilat do të ndikojnë në forcimin e shkathhtësive, shprehive motorike si dhe veprimin ritmik, duke iu përshtatur aftësive psikomotorike. Të arrihet që organizmi i fëmijëve t'u përshtatet kushteve të ndryshme të natyrës dhe jetës shoqërore. Të përvetësohen teknikat themelore nga përmbajtjet programore të mësimin të notit dhe skijimit të përfshira në këtë plan dhe program.</p>

VLERËSIMI

- **kontrollimi dhe vlerësimi i zhvillimit trupor (lartësia dhe pesha);**
- **kontrollimi i aftësive fizike-testi:** (kërcim së gjati nga vendi, përkulje në bankë, vrapim në 30 m nga starti i lartë, hedhja e topit prej 200 gramësh, gritja e trupit dhe qëndrim me krahe mbledhur në hekur);
- **kontrollimi dhe vlerësimi i i shkathtësive lëvizore** (teknikë e elementeve të lojërave sportive).

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME METODOLOGJIKE

Duke u nisur nga kushtet më të cilat shkollat tona i kanë për organizimin e procesit mësimor për këtë lëndë mësimore si dhe të përmbajtjeve programore të përfshira në këtë Plan dhe program për nxënësit e klasës IV-të do të këshillojmë:

- Që me kohë të sigurohen kushtet minimale për realizimin e përmbajtjeve programore (vendushtrimi, veglat dhe rekuizitat) që të programohen ato përmbajtje programore me qëllim që nxënësit të jenë sa më shumë të angazhuar, duke tentuar që të arrihen objektivat e kësaj lënde me nxënësit e klasës IV-të.
- Të shfrytëzohen të gjitha ato forma organizative të punës si dhe të respektohen parimet mësimore në zgjidhjen dhe realizimin e detyrave lëvizore, duke arritur që mësimi i programuar si ai i rregullt, ashtu edhe i zgjedhur e shtues, të kanë efektin e duhur në transformimin e organizmit të nxënësve si në aspektin fizik-motorik ashtu edhe psikik e social.
- Të shfrytëzohen aktivitetet e llojllojshme si dhe metodat, mjetet, veglat dhe rekuizitat me qëllim që të arrihen objektivat.

Gjatë organizimit të procesit mësimor në orën e edukatës fizike nuk duhet të shfrytëzohet vetëm një formë e punës, sepse do të ndikohet negativisht në interesimin-motivimin e nxënësve, sepse është e njohur se shfrytëzimi vetëm i një formë të punës nuk do të ketë efekt të duhur meqë format e punës frontale, grupore, në çifte dhe individuale, i kanë specifikat e veta-përparësitë si dhe mangësitë-dobësitë, andaj kërkohet që

ato të shfrytëzohen sipas kërkesave dhe kushteve reale didaktiko-metodike.

Duhet theksuar se disa nga përmbajtjet programore të përfshira në këtë plan dhe program, si njësi mësimore që duhet të organizohet-zhvillohet, në pjesën themelore të orës, nuk duhet të shfrytëzohen si njësi mësimore, por më tepër të shfrytëzohen si paraushtrime, sidomos ecjet dhe vrapimet. Mirëpo, pa marrë parasysh se kur dhe me çfarë qëllimi ecjet dhe vrapimet shfrytëzohen nga nxënësit duhet të kërkohet të ecin dhe të vrapojnë drejt, pa shtrëngim, kokën drejt-lartveprimi i këmbëve dhe krahëve drejt dhe në harmoni.

Në të gjitha rastet kur bëhet zhvillimi apo përsëritja e njesisë (detyrës) mësimore nxënësit, në pjesën themelore të orës, duhet të njoftohen teorikisht me teknikën e ekzekutimit të lëvizjes-ushtrimit që duhet ushtruar-përvetësuar, duke e kuptuar vlerën dhe rëndësinë për çka ata duhet të ushtrojnë.

Duhet theksuar se mësimdhënësit e mësimit klasor patjetër duhet të kenë aftësi profesionale që me sukses:

- t'u qasen problemeve që paraqiten gjatë organizimit të procesit mësimor;
- theks i posaçëm i kushtohet demonstrimit si dhe aplikimit të formave të punës në orën e edukatës fizike, sipas kushteve dhe kërkesave, duke pasur parasysh objektivat që duhet arritur;
- Gjendja psikike dhe sociale gjatë të ushtruarit të dominojë në frymë pozitive;
- Nëpërmes organizimit të drejtë të procesit mësimor të arrihet botëkuptimi i drejtë mbi vlerën dhe rëndësinë e këtij lëmi që e ka për shëndetin e tyre.

LITERATURA:

B. Hasangjekaj - Metodika e edukatës fizike, Prishtinë, 1998.

B. Hasangjekaj - Edukata fizike dhe sportive 1, Prishtinë, 2004.

Grup autorësh, Edukata fizike dhe sportive 2, Prishtinë, 2004.

Grup autorësh, Edukata fizike dhe sportive 3, në dorëshkrim-2005.

Planet dhe programet mësimore - kl: I, II, III - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

M. Koritnik - 2000 lojëra, Prishtinë, 1998.

M. Princ - Metodika shkollske shportne vegoja, Lublana, 1995.

Grup autorësh - Lojërat didaktike në kopshtin e fëmijëve, Tiranë.

Grup autorësh - Edukata fizike në shkollë, Tiranë, 1973.

M. Koshniçar - Edukata fizike e nxënësve të sh.f. kl. I-IV, Prishtinë, 1968.

Tirazhi: 2000 copë
Përgatiti për shtyp:
SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR – Prishtinë
Shtypi:
Shtypshkronja ALFAPRINT – Prishtinë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

Plani dhe programi mësimor : për klasën e katërt fillore / {Krye-
redaktor Fehmi Ismajli}. - Prishtinë : Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e
Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : "Alfaprint"). - 140 f. ; 24 cm.

Literatura : f. 137-138

ISBN 9951-450-79-2